



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2233/1 prot.

Tiranë, më 28.10.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 12585/2 prot., datë 15.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2233 prot., datë 16.10.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “*Mbi procedurën e paraqitjes së kërkesës, afateve, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit të strehimit social*” (në vijim “*projektvendimi*”), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, konstatohet se krijimi i programit të strehimit social i cili do të kryhet on line në portalin “e-Albania”, bazohet në ligjin nr. 22/2018 “*Për strehimin social*”.

Konkretisht, projektvendimi parashikon se, procesi për përfitimin nga programi i strehimit social, do të kryhet pas aplikimit dhe regjistrimit të aplikantit nëpërmjet portalit shtetëror e-Albania. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se të gjithë palët e përfshira në këtë proces përpunimi të dhënash, duhet të përmbushin parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim “*Ligji*”).

Gjithashtu, në lidhje me zbatueshmërinë e Ligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale që do grumbullohen nga portali “e-Albania” me qëllim ndërveprimin me strukturën përgjegjëse të strehimit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe niveli i aksesit të kësaj të fundit në programin e strehimit social.

Për më tepër, duke vlerësuar se një ndër qëllimet e këtij projektvendimi është përcaktimi i rrethit të institucioneve që do të kenë akses në këtë program si dhe niveli i aksesit në këtë të

fundit, sygjerojmë që në pikën 11 të projektvendimit, të qartësohen/specifikohen rolet e përdoruesve në akses në përputhje me detyrat e tyre funksionale me qëllim shmangien e aksesit të paautorizuar.

Me reflektimin e propozimeve të mësipërme, ky projektvendim do të konsiderohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi